



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 400/01-47697 dt. 02/11 2020

Në vështrim të nenit 13, 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenin 19 pika 1.3, të Rregullores Nr.12-320-19338, të datës 07.04.2017, për Kushtet , Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve njofton të gjithë fermerët e interesuar që të aplikojnë për Projektin e poshtëshënuara:

THIRRJE PËR APLIKIM

Në Projektin – FURNIZIMI ME MIKSER PËR USHQIM TË KAFSHËVE 2.0 M³ - BLEGTORI

Kriteret që duhet plotësuar për aplikim:

1. Fermeri duhet të jetë banorë i Komunës së Drenasit;
2. Ferma të jetë në territorin e Komunës së Drenasit;
3. Të jetë i regjistruar fermer;
4. Të posedoj fermën dhe krerët në emër të aplikuesit me 15 krerë e më shumë Gjedhe + Viça (përparësi fermerët me numër më të madh të krerëve);
5. Fletën poseduese dhe kopjen e planit për vendin ku gjendet ferma;
6. Të posedoj Traktor në pronësi për të shfrytëzuar Mikserin (duke filluar prej 40kf);
7. Të jetë i gatshëm për participim;
8. Përparësi në kushte të barabarta kanë aplikantët që nuk kanë përfituar më parë nga DBPZHR-ja, fermerët që nuk janë përfitues nga MBPZHR-ja dhe Donatorë të tjerë brenda vitit fiskal , fermerët të cilët jetojnë në zona malore, të rinjtë, femrat, familjet që kanë persona me nevoja të veçanta.

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

1. Plotësimi i aplikacionit ;
2. Vërtetimin e tatimit mbi pronë;
3. Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
4. Numrin identifikues të fermerit (NIF) (përparësi fermerët që janë të regjistruar para thirrjes publike),
5. Listën e verifikimit të kafshëve - Gjedheve të lëshuar nga sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I&R) në kuadër të AUV-së; (jo më të vjetër se 6 muaj);
6. Fletën poseduese dhe kopjen e planit ku gjendet ferma (në emër të aplikuesit, familjarit ose me kontratë të noterizuar);
7. Dëshmi për traktorin që posedon në pronësi;
8. Deklaratë për participim nga fermeri;
9. Dëshmi për persona me nevoja të veçanta (nëse posedoni).

Vërejtje :

- o Fermat duhet të jenë brenda territorit të Komunës së Drenasit;
- o Fermerët që posedojnë pajisjen për të cilën aplikojnë nuk mund të jenë përfitues;

- Përparësi feramat që kanë qasje për hyrje brenda me pajisjen që aplikon;
- Fermerët mund të jenë përfitues vetëm në një projekt të DBPZHR-së brenda vitit fiskal ;
- Të drejtë aplikimi ka vetëm një fermer nga një familje (nëse aplikojnë dy e më shumë fermer prej së njëjtës familje , asnjëri nuk mund të jetë përfitues);
- Të dhënat e lëshuara nga sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I&R) në kuadër të AUV-së duhet të jenë në emër të aplikuesit si dhe duhet të përputhen gjatë verifikimit nga komisioni në terren;
- Fermerët përfitues të mëhershëm nga DBPZHR që nuk ju kanë përmbajtur kontratës, aplikacioni i tyre nuk shqyrtohet;
- Objekti në të cilin operon ferma (gjenden krerët) duhet të jetë e ndërtuar në parcelën e kopjes së planit të dorëzuar (në pronësi ose me kontratë të qiramarrjes mbi 10 vite të noterizuar, apo të jenë në RDPP për pronat e marra me qera nga AKP-ja apo Komuna);
- Aplikacionet e pa plotësuara, pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen;
- Dorëzimi i aplikacioneve të behët në Arkiv – Komunë.

Afati i aplikimit nga data 02.11.2020 deri me 17.11.2020

Drenas, 2020



Shef i Komunës

Ramiz Sadrovci